



Pranuar / Dorezuar / Punëpunë/Produktuar / Received/Delivered	22.06.2023	3	viti god year
Organ /Njësia / Organ /Jednitsa / Org./Unit	Nr. Prot / Br. Prot / Prot No	Shtopim / Prilog / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity
SKIMSHICK	4883/2023		115



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.744/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.744/2023 të datës 17.05.2023 të parashtruar nga ankuesja kundër organit të punësimit Administrata Tatimore e Kosovës, në çështjen juridike „masë disiplinore“, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtura me datë 22.06.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Shfuqizohet** Vërejtja e datës 27.04.2023 nga Drejtori i Departamentit Tatimor Rajonal në Ferizaj në kuadër të Administratës Tatimore të Kosovës, e shqiptuar ndaj ankueses dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje te organi i njëjtë i cili e ka nxjerrë aktin e kontestuar administrativ.
- II. Obligohet** Drejtori i Departamentit Tatimor Rajonal në Ferizaj në kuadër të Administratës Tatimore të Kosovës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të bëjë rivlerësimin e shkeljeve të pretenduara disiplinore të ankueses dhe të veprojë në pajtim me pikëpamjet juridike si në arsyetimin e këtij vendimi.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

Arsyetim

Nëpunësja civile me datë 17.05.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjë A.nr.744/2023,

kundër masës disiplinore "Vërejtje" të datës 17.05.2023, e shqiptuar ndaj saj nga ana e Drejtorit të Departamentit Tatimor Rajonal në Ferizaj në Administratën Tatimore të Kosovës (*tutje vetëm ATK*), me pretendimet ankimore se kjo masë i është shqiptuar padrejtësisht si dhe në kundërshtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Rregulloren Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtareve Publike dhe Ligjin 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 19.05.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Administratës Tatimore të Kosovës, ndërsa kjo e fundit me datë 31.05.2023 ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 4268/2023 e datës 17.05.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vërejtjen me shkrim të datës 27.04.2023 e shqiptuar nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankueses; Vendimin me Nr.Prot.784 të datës 08.12.2022 nga Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së; Akt emërimit e ankueses AE.Nr.774/2022 të datës 27.12.2022; Vendimin me Nr.774/2022 të datës 27.12.2022 lidhur me transferimin e ankueses nga Drejtoresha e DMZP-së; Formularin mbi përshkrimin e detyrave të punës së ankueses; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 19.05.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 31.05.2023 nga Administrata Tatimore e Kosovës së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Komunikimin elektronik të datës 30.05.2023, 19.05.2023, 22.05.2023 ndërmjet Drejtorit të Departamentit Tatimor Rajonal në Ferizaj dhe zyrtareve të Njesisë së Burimeve Njerëzore në ATK; Komunikimin elektronik të datës 28.04.2023 ndërmjet Drejtorit të Departamentit Tatimor Rajonal në Ferizaj dhe ankueses; Komunikimet elektronike të datës 18.04.2023, 31.03.2023, 30.03.2023, 27.03.2023, 09.03.2023, 20.02.2023, 16.02.2023, 15.02.2023 ndërmjet Drejtorit të Departamentit Tatimor Rajonal në Ferizaj dhe nëpunësve të këtij regjioni e menaxhmentit të ATK-së lidhur me vonesat për lëndët e rimbursuara; Komunikimin elektronik të datës 31.03.2023 ndërmjet ankueses dhe Drejtorit të Departamentit Tatimor Rajonal në Ferizaj; Komunikimin elektronik të datës 30.03.2023, 27.03.2023, 09.03.2023, 20.02.2023, 16.02.2023, 15.02.2023 ndërmjet Zv.Drejtorit Ekzekutiv në Drejtorinë e Përgjithshme me Drejtorin e Departamentit Tatimor Rajonal në Ferizaj dhe vartësve të tij lidhur me vonesat e lëndëve të rimbursuara; E-mailat zyrtar të datës 28.04.2023 lidhur me shqyrtimin e vërejtjes nga Drejtori i Departamentit Tatimor Rajonal në Ferizaj për ankuesen dhe kundërshtimin nga kjo e fundit; Udhëzuesin për kohëzgjatjen e kontrolleve me numër reference REF.DKP-16/03/2022 të datës 16.03.2023; Formularin me numër reference DOR/DTM: 01-2022 lidhur me kërkesën për njoftimin dhe miratimin e kohëzgjatjes së kontrollit; Rregulloren e brendshme ATK NR.01/2020 mbi Procedurat e Rimbursimeve me Nr.Prot.09-06-708 të datës 12.02.2020.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka vlerësuar që lënda e ankueses sipas ankesës më numër 744/2023 të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje te organi që ka nxjerr aktin juridik të kontestuar, *sepse:*

Nga analizimi i shkresave të lëndës rrjedh se ankuesja është e punësuar në Administratën Tatimore të Kosovës dhe se e njëjta sipas Vendimit Nr.Prot.784 të datës 28.12.2022 të Zv. Drejtorit Ekzekutiv të ATK-së është emëruar dhe ushtron pozitën e punës “Zëvendësuese e Udhëheqësit të Divizionit për Aktivitete Operative” në Departamentin Tatimor Rajonal në Ferizaj.

Drejtori i Departamentit Tatimor Rajonal në Ferizaj në cilësinë e Udhëheqësit të drejtpërdrejtë të ankueses, me datë 27.04.2023 ka shqiptuar ndaj të njëjtës masën disiplinore “Vërejtje”, për shkak të mos përfundimit të kontrollave të rimbursimit sipas kategorisë C brenda afateve të përcaktuara me akte ligjore në fuqi të ATK-së.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil pretendon se masa disiplinore në fjalë është shqiptuar padrejtësisht ndaj saj si dhe në kundërshtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Rregulloren Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtareve Publike dhe Ligjin 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat. Propozon që Këshilli të aprovoj ankesën dhe të anuloj masën disiplinore “Vërejtje” si të pa drejtë dhe të pa bazuar.

Në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses, Kolegji i Këshillit i’u referua dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë që rregullojnë disiplinën dhe procedurën disiplinore të nëpunësve civil, përkatësisht:

Nenit 45, me të cilin është përcaktuar se: “Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. “ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;” 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit”.

Nenit 46, me të cilin është përcaktuar se: “... Shkeljet disiplinore ndahen në: 2.1. shkelje të rënda; 2.2. shkelje të lehta. 3. Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mos përmbushja e detyrave të punës; 3.2. mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasojë të rënda; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 3.4. përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrës; 3.5. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë; 3.6. shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; 3.7. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 3.8. kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi; 3.9. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar apo të mirëbesimit për të dhënat e klasifikuara si të tilla; 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi; 3.11. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera psikotrope të ndaluara ose të alkoolit në vend të punës dhe ardhja i dehur në punë. 4. Shkelje të lehta konsiderohen: 4.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune; 4.2. shkelja e rregullave të etikës; 4.3. sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun; 4.4. kryerja e veprimeve, që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar.

Nenit 47 paragrafit 1, me të cilin në mënyrë taksative janë përcaktuar masat disiplinore: “Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë,

duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil”.

Nenit 48, me të cilin është përcaktuar kompetenca lëndore për shqiptimin e masave disiplinore “1. Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. 2. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil.

Po ashtu, Kolegji për shqyrtim të drejtë të kësaj çështje mori parasysh edhe Rregulloren (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, me theks të veçantë dispozitat e nenit 7 dhe 8 të kësaj rregullore ku përcaktohet se: **Neni 7 Fillimi i procedurës disiplinore** 1. Mbikëqyrësi i Drejtpërdrejtë në rastet kur vihet në dijeni të një pretendimi për shkelje disiplinore, nëpërmjet ankesave nga qytetarët apo institucione jashtë strukturave të institucionit, e vlerëson paraprakisht atë. 2. Procedura disiplinore fillon pa vonesë, me marrjen në dijeni për një shkelje disiplinore brenda afateve të përcaktuara në nenin 48 paragrafin 7 të Ligjit. 7. Komisioni disiplinor fillon procedurën disiplinore edhe në rastet kur paraqiten elementet e përcaktuara në nenin 48 paragrafi 4 nën paragrafi 4.2 dhe 4.3 të Ligjit. **Neni 8 Kompetenca për masat disiplinore** 1. Ndaj nëpunësve civil, zbatohen masat e përcaktuara në nenin 47 të Ligjit. 2. Masa disiplinore e përcaktuar në nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 i Ligjit jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i nëpunësit civil, nëse nëpunësi ka bërë shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 46 paragrafi 4 nën paragrafi 4.1, 4.2, 4.3 dhe 4.4 të Ligjit. 3. Masat disiplinore të përcaktuara në nenin 47 paragrafin 1 nën paragrafi 1.2, 1.3 dhe 1.4 i Ligjit shqiptohen nga Komisioni Disiplinor, nëse nëpunësi civil ka bërë shkelje të dispozitave të përcaktuara në nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafët 3.1 deri 3.11 të Ligji. 4. Masat disiplinore vendosen dhe regjistrohen në dosjen personale të nëpunësi”

Rrjedhimisht në kuptim të kuadrit si më sipër, Kolegji i Këshillit ka analizuar aktin e kundërshtuar me ankesë përkatësisht masën disiplinore “Vërejtje” të datës 27.04.2023, e shqiptuar ndaj ankuses nga Drejtori i Departamentit Tatimor Rajonal në Ferizaj në cilësinë e Udhëheqësit të drejtpërdrejtë, nga dhe ka konstatuar se masa disiplinore në fjalë është shqiptuar për shkelje disiplinore sipas nenit 46 paragrafit 3 nën paragrafit 3.2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, pra për shkelje të rëndë disiplinore “mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja të rënda”. Ndërlidhur me këtë fakt e në mbështetje të nenit 48 paragrafit 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Kolegji konstaton se trajtimi i shkeljeve të rënda disiplinore bie në kompetencë të Komisionit Disiplinor, kështu që nisur nga ky konstatim rrjedhë se Drejtori i Departamentit Tatimor Rajonal në Ferizaj ka tejkaluar kompetencën materiale lidhur me këtë çështje juridiko administrative.

Andaj, duke qenë se masa disiplinore “Vërejtje” e datës 27.04.2023 e shqiptuar nga Drejtori i Departamentit Tatimor Rajonal në Ferizaj ndaj ankuses, përmban të meta të tilla të cilat pamundësojnë vendosjen meritore lidhur me këtë çështje juridiko-administrative, Kolegji i Këshillit vlerësoi që çështja të kthehet në ri-shqyrtim dhe rivendosje te organi i njëjtë, me detyrimin që Drejtori i Departamentit Tatimor Rajonal në Administratën Tatimore të Kosovës, brenda afatit të përcaktuar si në pikën II të dispozitivit, të bëjë rishqyrtimin e kësaj çështje disiplinore dhe të veproj në pajtim me dispozitat e nenit 7 paragrafit 3, 4, 5, dhe 6 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë ku përcaktohet se: ...”Nëse njoftimi i marrë nuk rezulton të ketë elemente që mund të klasifikohen si





shkelje disiplinore, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë vendos të mos e fillojë procedurën disiplinore, duke e arsyetuar me shkrim mos fillimin e procedurës dhe për këtë e njofton paraqitësin e shkeljes së pretenduar përmes njoftimit formal sikurse që përcaktohet me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. 4. Në rast se informacioni i marrë rezulton të ketë elemente si shkelje disiplinore, Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë bën kualifikimin e shkeljeve sipas nenit 46 të Ligjit. 5. Në rast se shkelja klasifikohet sipas nenit 46 paragrafi 4 nën paragrafët 4.1 deri 4.4 të Ligjit, Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë fillon procedurën disiplinore sipas nenit 48 paragrafit 2 të Ligjit. 6. Në rast kur shkelja kualifikohet sipas nenit 46 paragrafi 3 nënparagrafët 3.1 deri 3.11 të Ligjit, Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë kërkon nga komisioni disiplinor të fillojë procedurën disiplinore sipas nenit 48 paragrafi 4 nën paragrafi 4.1 të Ligjit. Pra mbikëqyrësi i ankueses në rast të kualifikimit se ankuesja ka bërë shkelje të lehtë disiplinore duhet të shqiptoj masën disiplinore sipas nenit 47 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ose në rast të kualifikimit se ankuesja ka bërë shkelje të rëndë disiplinore atëherë rastin duhet ta përcjell për tek Komisioni Disiplinor i ATK-së në pajtim me nenin 7 paragrafin 6 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë.

Theksuar si më lartë, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.744/2023

Ardita Percuku-Shyti

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Udhëheqëses së Njësisë së Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

